



RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

*Mbi Auditimin Ligjor të Fondeve të Përftuara dhe të
Shpenzuara gjatë fushatës elektorale Qershor 2019*

“Partia Bindja Demokratike”

Auditues Ligjor: Shkelzen MARGJEKA



Tiranë me 12.12.2019



**RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR MBI AUDITIMIN LIGJOR TË FONDEVE
TË PËRFTUARA DHE TË SHPENZUARA GJATË FUSHATËS ELEKTORALE
QERSHOR 2019 PARTIA “BINDJA DEMOKRATIKE”**

DREJTUAR: KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

TIRANË

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Ne jemi angazhuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me kontratën e shërbimit nr.5054 Prot. të lidhur me datë 01.06.2019 në misionin e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për zgjedhjet për organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019 për Partinë “Bindja Demokratike” të raportuar në KQZ përmes informacionit, përmbledhjeve financiare dhe deklarata të subjektit të depozituar me datë 29.08.2019 .

A. INFORMACIONI LIGJOR

i. Kuadri ligjor

Bazuar ne Ligjin 10019 date 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Ligji Per Partite Politike Nr.8580 date 17/02/2000 i ndryshuar me ligjin nr. 10374 date 10/02/2011, ligjin nr. 17/2014 date 20/02/2014 ligjin nr. 25/2014, date 25/09/2014, ligjin nr.90/2017

Ligji Nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor Organizimin e profesionit te Audituesit Ligjor dhe Kontablit te Miratuar, i ndryshuar me Ligjin 10297 date 08/07/2010.



Ligji Nr.9228 date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”i ndryshuar’
Gjithe dokumentacioni ligjor i marre prane Partia Bindja Demokratike.
(statuti,akti i themelimit).

Vendimi nr.152date 11.04.2019 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për formatet e
standartizuara të raporteve të auditimit që do të dorëzohen ne KQZ.

ii. Standartet e kontabilitetit të zbatueshme

Standartet Kombëtare të Kontabilitetit që përdoren në Shqiperi

Standardi Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo Fitimpruese (SKK për OJF-të).

B. OBJEKTI I AUDITIMIT

i. Kontrata e shërbimit

Kontrata Nr.5054 Prot. date 01.06.2019 lidhur midis z.Shkelzen Margjeka, Auditues Ligjor
(Ekspert Kontabel i Regjistruar) dhe Komisionit Qendror te Zgjedhjeve përfaqësuar nga
z.Ylli Merkaj, Sekretar i Përgjithshëm

ii. Vendimi i KQZ-së.

Vendimi nr.740 date 31/05/2019 për Shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e
Ekspertëve Financiarë dhe Audituesve Ligjorë të cilët do të kryejnë Monitorimin dhe
Auditimin e Fondeve dhe Shpenzimeve të Fushatës Zgjedhore nga Subjektet Zgjedhore për
Organet e Qeverisjes Vendore të Vitit 2019.

iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

- Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave
financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi
përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshëm të përshtatshëm mbi
paraqitjen e sinqertë të informacioneve dhe deklaratave financiare pa anomali
materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të
përshtatshme kontabël,dhe kryerjen e cmuarjeve kontabël të asyeshme për rrethanat.
- Përgjegjësitë e audituesit ligjor:



- Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto informacione të subjektit zgjedhor, si përmbledhje financiare dhe deklaratat financiare bazuar në auditimin tone. Auditimi jone u bë në përputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit.
- Keto standarte kërkojnë që Ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare, informacionet dhe deklaratimet financiare nuk kanë anomali materiale. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.
- Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm përkatës të entitetit në përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të informacioneve dhe deklaratimeve financiare në mënyrë që të hartojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat por jo për qëllimin e shprehjes së opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali në informacioneve dhe deklaratimeve financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm përkatës të entitetit në përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të informacioneve dhe deklaratimeve financiare në mënyrë që të hartojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat por jo për qëllimin e shprehjes së opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi, gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmerisë së metodave kontabel të përdorura dhe llogjikën e cmuarjeve kontabel të bera nga drejtimi si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të informacioneve dhe deklaratimeve financiare dhe të pasqyrat financiare.

Në besojmë që evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.



Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në faqen e internetit të Institutit të Eksperteve Kontabël të Autorizuar në web: www.ieka.al. Ky përshkrim përbën pjesë të raportit tonë të auditimit.

C. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

- **Partia “BINDJA DEMOKRATIKE” BD**, është regjistruar me datë 23 Prill 2019, me nr.118/1 Prot Gjykata e Tiranës.
- Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit nr.8580, date 17.02.2000 “Për Partitë Politike” i ndryshuar.

Në programin e saj Partia Bindja Demokratike prezanton se:

- Bindja Demokratike është ide, nuk është pronë, as biznes apo njeri. Ajo ka lindur nga bindja e fortë e qytetarëve të lirë të këtij vendi për një projekt të ri politik.
- Bindja Demokratike është dhe do të jetë një ofertë serioze dhe tërësisht e pavarur, sa herë që të ketë zgjedhje në Shqipëri. Bindja Demokratike është frymë dhe alternativë e re, në një shoqëri, ku monopoli partitokratik po vret konkurrencën dhe ka kufizuar lirinë e zgjedhjes për qytetarët.
- Ndryshimi i sistemit dhe çlirimi i zgjedhjeve, kauza jonë Sistemi ynë politik bazohet tek garancia që dy rivalët kryesorë në vend i kanë dhënë njëri tjetrit, për të nënshtruar çdo ide apo frymë demokratike brenda kampeve të tyre. Republika e Shqipërisë de facto nuk është as demokratike dhe as parlamentare, sepse si e tillë ekziston vetëm në letër. Ne gjendemi sot nën një rregjim atipik dhe hibrid, i cili është sistemi i partitokracisë, i prodhuar kryesisht nga nevoja që dy partitë e mëdha kanë pasur për të garantuar pushtetin brenda tyre.
- Bindja Demokratike është një alternativë e re kundër këtij regjimi dhe ne do të bëjmë gjithçka mundemi që ai të rrëzohet. Gjithkush do të ketë kohën dhe mundësinë që të na vlerësojë në të ardhmen për qëndrimet dhe aktet tona. Bazamenti ynë politik është fuqia që do t'i japim votës së çdo qytetari, i cili do të bëhet pjesë e rrugëtimit tonë.



- Bindja Demokratike do të qeveriset si një parti e lirë që të shërbejë si model për mënyrë se si partitë duhet të qeverisin Shqipërinë.

ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit (qendra dhe degët rajonale): numri i anëtarëve, struktura dhe numri i degëve në qark dhe organizatat që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me partinë (për shembull, fondacionet, organizatat e rinisë, etj.)

Partia Bindja Demokratike nuk ka një organizim të mirfilltë strukturor duke qënë se është akoma në process strukturimi dhe ngritje, të cilën kanë nenshkruar 4,000 persona per formimin e saj.

Partia Bindja Demokratike me datë 22 Prill 2019 në mbledhjen e anëtarësisë, nismëtarë për krijimin e kësaj force politike kanë miratuar statutin dhe akt-themelimin si dhe kanë zgjedhur një bord i përkohshëm prej 6 persona deri në zgjedhjen e të gjitha organeve te Bindjes Demokratike në perputhje me percaktimet statutore.

Në krye të këtij bordi në cilësinë e kordinatorit të tij u zgjodh zoti Astrit Patozi.

Financat e Partisë

1. Burime financiare te Bindja Demokratike janë kuotat e anëtarësisë; çdo pasuri e fituar në mënyrë të ligjshme; fondet publike duke përfshirë edhe ndihmën financiare në masën e caktuar në Buxhetin e Shtetit; dhuratat në vlerë monetare, natyrë ose shërbime, sponsorizime, si dhe çdo transaksion tjetër financiar nga individë, persona juridikë apo fizikë, organizata e fondacione politike, në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe sipas procedurave ligjore përkatëse.

Bindja Demokratike nuk mund të pranojë dhurata nga persona juridikë apo fizikë, që mund të ndikojnë në veprimtarinë e saj.

2. Masa e kuotës së anëtarësisë përcaktohet nga Berthama. Grumbullimi dhe administrimi i kuotave e kontributeve bëhet konform rregullores së brendshme. Gjatë kësaj periudhe nuk kemi kuota të mbledhura.



D. PARAQITJA E RAPORTIT DHE STRUKTURAT E TIJ

i. Struktura e raportit të auditimit – kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet.

**2.b Të ardhurat Monetare-Financime
jopublike**

A.Statusi I dhuruesit	B.Emri i dhuruesit	c.Mbiemri dhuruesit	D.Adresa	Shuma e dhuruar ne euro	H.Shuma e dhuruar në lekë	I.Data e dhurimit	K.Metoda e dhurimit
	Astrit	Patozi	Tiranë		100,000.00	25.05.2019	Cash
	Ardi	Kollozi	Vlorë		100,000.00	25.05.2019	Cash
	Andi	Permati	Tiranë		100,000.00	25.05.2019	Cash
					300,000.00	leke	
	Arben	Skenderaj	Tiranë	600 Euro	72,923.00	leke	
	Kristi	Bello	Tiranë	500 Euro	60,770.00	leke	
		Totali ne cash			433,693.00		



2.C Të ardhura , dhurime në natyrë-Financime jopublike

A.Statusi i dhuruesit	B.Emri i dhuruesit	c.Mbiemri i dhuruesit	D.Adresa	G.Numri i identifikimit	H.Shuma e dhuruar në natyre	I.Data e dhurimit	K.Metoda e dhurimit
Person fizik	Fabian	Topollari	Tiranë	32648643	100,000.00	01.06.2019	Në Natyre
Person fizik	Valbona	Mezini	Vlorë	I 16015110 J	35,000.00	01.06.2019	Në Natyre
Person fizik	Valbona	Sakollari	Durrës	H 455321176 I	20,000.00	01.06.2019	Në Natyre
Person fizik	Leonard	Olli	Korce	G 51025155 N	25,000.00	01.06.2019	Në Natyre
Person fizik	Shkelzen	Qoka	Diber	H 20401173 N	15,000.00	01.06.2019	Në Natyre
Person fizik	Shkelzen	Qoka	Maqellare	H 20401173 N	10,000.00	01.06.2019	Në Natyre
Person fizik	Shkelqim	Muhaj	Këlcyrë	H 61201018 F	8,000.00	01.06.2019	Në Natyre
Person fizik	Merita	Xhika	Cerrik	H 86214011 D	10,000.00	01.06.2019	Në Natyre
Person fizik	Arben	Pohuni	Shijak	G 30527165 A	15,000.00	01.06.2019	Në Natyre
Person fizik	Robert	Brahaj	Mallakaster	G 70611123 N	24,000.00	01.06.2019	Në Natyre
Person fizik	Ibrahim	Ismaili	Gramsh	F 70131064 N	10,000.00	01.06.2019	Në Natyre
Person fizik	Erjon	Kaiku	Tiranë	I 60912084 P	50,000.00	01.06.2019	Në Natyre
Totali ne natyre					322,000.00	leke	
Totali i të ardhurave					755,693.00	lekë	



ii. Përmenden takimet dhe komunikimet e mundëshme midis audituesit dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë.

Menjëherë pas lidhjes së kontrates për monitorimin dhe auditimin ligjor të fondeve të Përfuara dhe të Shpenzuara gjatë fushatës elektorale Qershor 2019, ne kemi marre takim me përfaqesuesit e partisë Bindja Demokratike dhe kemi qënë në kontakt të vazhdueshëm gjatë gjithë fushatës elektorale si dhe pas mbylljes së fushates. Kemi takur përfaqësuesit si dhe kandidatët për kryetar bashkie në zgjedhjet vendore Qershor 2019 në të gjitha bashkitë ku subjekti Bindja Demokratike kishte kandidat.

Personi kryesor i komunikimit gjatë gjithë kohës së monitorimit dhe auditimit te subjektit Bindja Demokratike ka qënë z.Fabian Topollari, i cili ka qënë i angazhuar për të bërë më të lehtë realizimin e misionit tonë si ekspert financiar dhe auditues ligjor.

Ne kemi marre gjitha dokumentacionin që dispononte subjekti zgjedhor dhe mbi bazen e gjetjeve kemi pergatitur dhe raportin e auditimit.

iii. Jepet një paraqitje e përgjithshme në lidhje me raportin e financimit të fushatës zgjedhore të kontrolluar: nëse është ose jo në përputhje me kërkesat e raportimit.

Në vijim të punës sonë për të verifikuar veprimtarinë financiare të Partisë Bindja Demokratike gjatë fushatës elektorale Qershor 2019 si dhe gjatë auditimit të dokumentacionit që zotëron nuk kemi konstatuar informacione apo deklarime financiare të cilat kanë qëllim të shmangin pasqyrimin e financimeve apo shpenzimeve të realizuara gjatë kësaj fushatë.

Ne kemi konstatuar se ka mungese stafesh profesionale në përgatitjen dhe paraqitjen e informacioneve financiare të cilat kanë vështirësuar punën në realizimin e procesit të auditimit.

Parti Bindja Demokratike nga auditimi rezulton se ka disa mosperputhje te vogla mes deklarimeve dhe monitorimit te cilat nuk jane ne vlera materiale, nga vleresimi i bere nga ana jone.



Ne deklarin e të ardhurave ka deklaruar se ka të ardhura në cash dhe në natyrë. Në kontributin në natyrë përfshihen zyrat elektorale të dhëna për perdorim gjatë fushates elektorale si dhe një furgon i cili është perdorur gjatë fushates nëper rrethe, ku jane vendopsur dhe fotot e kandidateve. Në deklarim e të ardhurave ka deklaruar vetem vleren e derdhur në arken e Partisë në Qender e cila është 300,000 leke, por jo vlerën prej 1,100 euro të derdhur në degen e Tiranës, kjo vlerë e konvertuar në 133,693 lekë.



II. KËRKESAT FORMALE

A. PËRMBLEDHJE

1/ Data e dorëzimit			
	a) dorëzim në formë elektronike	Po	29.08.2019
	b) dorëzim fizik	Po	29.08.2019
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po	26.08.2019
3/ Llogariabankaree veçantë / Personi përgjegjës i financës			
	a) evidenca e hapjes së llogarisë bankare	Jo	
	b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës	Jo	
	c) identiteti i personit përgjegjës të financës	Po	Erjon Kaiku



B. ANALIZA

a/ Llogaria bankare e veçantë

- **A është unike llogaria bankare (vetëm për qëllimin e fushatës zgjedhore) ?**
 - Subjekti zgjedhor nuk ka hapur llogari bankare gjatë fushatës dhe nuk ka marrë ndonjë shumë që kalon vlerën 100,000 leke.
 - Subjekti zgjedhor nuk ka llogari bankare të hapura të cilat mund të përdreshin për për të marrë financime publike dhe për të paguar shpenzimet.
 - *Subjekti zgjedhor nuk ka llogari bankare "të fjetura" që janë përdorur për zgjedhjet e mëparshme.*
 - Nga auditimi i dokumentacionit nuk na rezulton që subjekti zgjedhor të ketë detyrime të pashlyera apo borxhe. Subjekti politik Bindja Demokratike nuk ka borxhe për të shlyer të krijuara gjatë fushatës elektorale si dhe nuk ka diferenca negative në bilancin e saj.

- **A është siguruar i gjithë informacioni?**
 - Evidenca e çeljes së llogarisë bankare (data, dokumenti nga banka).
 - Nuk ka llogari bankare të çelura.
 - Dokumenti i lëvizjeve bankare (bank statement) që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.
 - Nuk ka llogari bankare të çelura.

b/ Personi përgjegjës për financën

- **Identiteti i personit përgjegjës për financën:**
 - Erjon Kaiku, është financier i parties, i cili bën punën në menyre vullnetare.
 - Nuk ka çështje të mospërputhjeve të mundëshme.



- Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:

- o Nënshkrimi i raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

Raporti i financimit te fushates është nënshkruar nga financier z.Erion Kaiku dhe personi përgjegjës në marrëdhëniet me KQZ , z.Fabian Topollari.

- o Përgatitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: zbulimi i problemeve të paraqitjes (shiko më poshtë)

a) bosh/mungon informacioni	Po / Jo	Çfarë?	
b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
	Të Ardhurat		
		Financime publike	0
		Donacione private	755,693
		Financim nga burimet e veta të partisë	0
		Huatë/Kreditë	0
	Shpenzimet		
		Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	379,810
		Materialet promovuese	62,323
		Media	108,560
		Sondazhe të Opinionit Publik	0
		Botime	0
		Transporti	50,000
		Konsulenca	0
		Reklamime në	0



			ambiente të hapura	
			Administrative dhe të përgjithshme	105,000

III. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi publik			
	Shuma e pagesës paradhënie	0	0
	Data e tranfertës	-	-
	Shuma e pagesës së marrë pas zgjedhjeve	1,820,000	0
	Data e transfertës	-	-
	Shuma e financimit publik e kthyer, nëse ka	0	0
	Data e transfertës	-	-
2/ Donacionet private			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	300,000	755,693
	Shuma e donacioneve në para	300,000	433,693
	Shuma e donacioneve në natyrë	322,000	322,000
	Paraqitja e një liste të donatorëve		
	1.Astrit Patozi (Person fizik)		100,000
	2.Ardi Kollozi (Person fizik)		100,000
	3.Andi Permeti (Person fizik)		100,000
	4.Arben Skenderaj(Person fizik) 600 euro		72,923
	5. Kristi Bello (Person fizik) 500 euro		60,770
	Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)		S'ka
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bakare (bank statement) (shuma)		Po
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bakare (bank statement) (data)		Po
	Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori)		Po



	Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)	Po
	A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?	Po
	Respektimi i kufirit të donacionit	Po
3/ Financimi nga burimet e vetë partisë		
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0
	Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)	0
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>	0
	<i>Botimet</i>	0
	<i>Shtypshkronja</i>	0
	<i>Marrje me qera</i>	0
	Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)	0
	<i>Kuotat e anëtarësisë</i>	0
	<i>Botimet</i>	0
	<i>Shtypshkronja</i>	0
	<i>Marrje me qera</i>	0
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(shuma)	0
	Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(data)	0
4/ Huatë/Kreditë		
	Shuma e përgjithshme e raportuar	0
	Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)	0
	Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)	0
	Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua)	0
5/ Marrja/Arkëtimii të ardhurave		
	Të gjithë të ardhurat në para të marra	Po 755,693



B. ANALIZA

a/ Financimi publik

- Shuma dhe data e transferimit të pagesave para zgjedhore dhe pas zgjedhore të marra nga shteti: çfarë ndodh nëse pjesa e caktuar publike që duhet ndarë pas zgjedhjeve nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet zgjedhore → që do të thotë se raporti i financimit të fushatës zgjedhore (dhe llogaria bankare) është në deficit (kundrejt standardeve të kontabilitetit?)
- Subjekti zgjedhor nuk ka marrë financime publike deri në momentin që kemi mbyllur auditimin.
- Kontrolli iminutazhit që subjekti zgjedhor ka marrë nga çdo sektor i medias që siguron kohë të lirë transmetimi.
- Rasti/et e abuzimit/keqpërdorimit të burimeve publike, që janë burimet e siguruara nga shteti, përveç hapësirës së lirë të reklamave dhe kohës së lirë të transmetimit (*do të trajtohen më me hollësi në pjesën e shpenzimeve*).

b/ Financimi nga burimet jo publike

- Donatorët e lejuar:

- o Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar;
- o Kontributi është bërë në vlerën 100,000 leke nga tre prej anetareve e dokumentuar përmes arketimit në arken e Partisë si dhe donacioni prej 1,100 euro në vlerë 500 euro nga dhe 600 euro nga kandidati për kryetar bashkie Tiranë dhe një person fizik.
- o Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror dhe nga një degë e partisë;
- o Kontributi në para në nivel qendror është 300,000 leke, ndërsa në nivel dege është 1,100 euro konvertuar në 133,693 leke.



- **Burimet e palejuara**

- Nuk kemi konstatuar burime te palejuara gjate kryerjes se auditimit.
- Kontributet në natyrë janë në vlerën 322,000 leke, që përfshin vleren e zyrave te vene ne dispozicion si dhe nje furgon qe eshte perdorur ne fushate.

o **Vlerësimi:**

- Dallimi mes kontributit në natyrë (dhe mundësisht) sponsorizimit dhe veprimtarisë vullnetare;
- Kemi kontribute ne natyre, kryesisht dhena e zyrave permes kontrate huaperdorje, ku deklarohet në kontratat e lidhura me subjektin zgjedhor se të gjitha detyrimet tatimore qe rrjedhin nga qiradhenia do të paguhen nga dhenesi i zyres apo mjetit levizes, tip furgon.
- Vlerësimi (rregulli i 10% më të ulët se çmimi i tregut apo mallrave/shërbimeve që arrijnë vlerën më shumë se 50,000 Lekë).
- Nuk kemi konstatuar anomali në vleren e qirase së objekteve.

o **Kufizimet**

- Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një degë e partisë;
- Nuk ka donator të tjerë përveç atyre që kemi paraqitur më lart në pasqyrën e të ardhuravë, donacionet e të cilët janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- Kufizimet (pragu i raportimit dhe deklarimit zbatohet si për kontributet në para ashtu edhe për ato në natyrë – *si të garantojmë respektimin e kësaj dispozite kur raportet e financimit të fushatës zgjedhore konsolidojnë llogaritë e selisë së partisë me ato të degëve?*)



c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike

- **Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë**
 - o Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe e detajuar sipas shumave të marra janë zero lekë
 - o Botimet janë zero lekë
 - o Shtypshkronjat janë zero lekë
 - o Marrja me qera janë zero lekë.

- **Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës**
 - o Zyrat Qendrore janë arkëtuar 300,000 lekë

 - o Degët lokale (Dega Tiranë) janë arkëtuar 133,693 lekë (Perkatesisht 1,100euro)

- **Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruar dhe deklarimit bankar (bank statement) (mund të përdoret edhe termi “nxjerrje e llogarisë”)**

- Shuma e të ardhuravë të deklaruar nga ana e subjektit përputhet me të ardhurat e realizuara, këto të derdhura në arkën e Subjektit Bindja Demokratike ose në natyrë. Nuk kemi të ardhura të realizuara dhe derdhura në banka.

- Nuk ka të hapur llogari të veçanta në banka dhe nuk kemi derdhje të tilla.

d/ Huatë/Kreditë

- o Nuk ka huadhënës dhe kreditë janë zero lekë, ndaj në këto kushte nuk kemi deklarime në lidhje me huatë, kredite apo të dhën të tjera të kërkuara dhe konstatuara.



IV. SHPENZIMET

A. PËRMBLEDHJE

Shuma e përgjithshme e raportuar		705,693 leke					
Respektimi i kufirit të shpenzimit		Po					
Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Fatura të Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzi me të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	379,810						379,810
Materialet promovues							
Media	50,000	50,000					50,000
Sondazhet e opinionit publik							
Botimet							
Transporti	50,000						50,000
Konsulencia							
Reklamat në ambientet e jashtme							



Administrative dhe të përgjithshme	105,000	105,000					105,000
Shpenzimet e bëra nga degët e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Fatura të Përgjithshme	Dokumentet e mbështetëse që mungojnë	Shpenzimet të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës							
Materialet promovuese	62,323	62,323					62,323
Media	58,560	58,560					58,560



Sondazhet e opinionit publik							
Botimet							
Transporti							
Konsulenca							
Reklamat në ambientet e jashtme							
Administrati ve dhe të përgjithshme							
Shpenzimet zgjedhore							
Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë							Jo



B. ANALIZA

a/ **Respektimi i kufirit të shpenzimeve:** 280 milion Lekë → fokusohuni tek “fushatat e shumëfishta” të bëra në nivel qendror dhe degët e partisë në të gjithë vendin;

Konstatojme se subjekti Bindja Demokratike nuk ka kaluara kufirin e shpenzimeve të përcaktuar me ligj në nivel qendror dhe në degët e saj.

b/ **Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruarra dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.**

- **Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës (fokusohuni tek këto);**
 - Pagesa për vendin nuk ka.
 - Shpenzimet e zbavitjes nuk ka .
 - Shpenzimet e pajisjeve nuk ka.
 - Shpenzimet për pijet nuk ka dokumenta të rregullta megjithese gjate fushates ne disa takime kemi vu re disa pije që janë ofruar, megjithese ne vlera të vogla.
 - Shpenzimet e dekorit/vizuales nuk ka.
 - Shpenzimet e Transportit jane ne vleren 50,000 leke.
 - Shpenzimet e Administratës nuk ka.

- **Materialet promovuese janë në vleren 62,323 leke të paguara nga kandidati për bashkinë e Tiranës**
- **Media ka shpenzime në vlerën 108,560 leke.**
- **Sondazhet e opinionit public nuk ka.**
- **Botimet nuk ka.**
- **Transporti ka shpenzime në vlerën 50,000 leke.**
- **Konsulenca nuk ka.**
- **Reklamat në ambientet e jashtme nuk ka.**
- **Administrative dhe të përgjithshme janë në vlerë 105,000 lekë.**



3. PËRFUNDIMI

A. SINTEZA

- **Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve**
- Për verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve u krye verifikimi dhe kontrolli i dokumentave, si dhe paraqitja në librat kontabël ku paraqitet pasqyra e përfitimit dhe përdorimit të fondeve dukë dhënë një pamje të qartë të destinacionit e përdorimit të tyre.
- Në shpenzime janë përfshirë të gjitha dokumentat justifikuese; megjithëse një pjesë e faturave nuk janë fatura të rregullta tatimore.
- Të ardhurat e realizuara janë nga kontributi i anëtarësisë.
- Të ardhurat i kemi në cash përmes derdhjeve në arken e subjektit Bindja Demokratike dhe në natyrë përmes dhënies së zyravë elektorale pa qera gjate fushatës elektorale si dhe një furgon.
- Shpenzimet e realizuara në cash dhe në natyrë janë bërë gjatë periudhës Qershor 2019, kjo në afatet e përcaktuara nga ligji.
- Te gjitha zyrat elektorale jane marrë për një muaj me kontratë huapendorje, këto të vëna në dispozicion nga kandidatet për kryetar bashkie në një 11 zona elektorale ku Bindja Demokratike ka pas kandidatë për kryetar bashkie.
- Kontributi ka qënë në vlera 100,000 leke e me poshte, dhe janë paraqitur dokumenta të derdhjes së vlerave si dhe të dhënat e personave që kanë kontribuar, paraqitur dhe në raport nga ana jonë.
- **Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit**
- Ka realizuar disa shpenzime me dokumenta jo te rregullta tatimore, duke qënë se disa blerje jane realizuar nga kandidatet për kryetar bashkie.
- Shpenzimet e naftës nuk janë marre me fature tatimore por vetëm me kupon tatimor.
- Shpenzimet për pije të ofruara nga kandidatët gjatë takkimeve elektorale nuk janë pasqyruar.



- **Krahasimi me raportin e monitorimit të ekspertit financiarë?**
- Nga krahasimi i raportit të auditimit me raportin e monitorimit vlerësojmë se në përgjithësi ka një përputhje mes deklarimeve me vlerësimet tona të realizuara gjatë monitorimit të fushatës, vlera e mospërputhjeve është jomateriale, kjo kryesisht në përcaktimin e vlerave të promovimit të cilat ka vështirësi në përcaktim në mënyrë indirekte duke pasur një treg me çmime të ndryshme.
- Nuk kemi të pasqyruar shpenzime për reklama apo publicitet, për intervistat e realizuara nga kordinatori i subjektit apo kandidatet për kryetar bashkie.

B. PËRFUNDIMI

Opinionit me rezervë

Ne kemi audituar dokumentat, informacionet, përmbledhjet financiare si dhe deklaratat e subjektit zgjedhor Partia "Bindja Demokratike" të depozituar me datë 29.08.2019 në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me fondet e përfituara dhe të shpenzuara për zgjedhjet për organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019 për periudhën 01.04.2019-30.09.2019, kjo në përputhje me ligjislacionin në fuqi.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, informacionet, përmbledhjet, pasqyrat financiare si dhe deklaratat paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Partisë Bindja Demokratike për periudhën e zgjedhjeve vendore Qershor 2019, dhe performancën financiare e flukset e parasë për periudhën që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Ligjin 8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar dhe Ligjin nr. 9228 date 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar.



Baza për opinionin me rezervë

Personat përgjegjës për mbajtjen dhe paraqitjen dokumentave financiare, nuk kanë mbledhur të gjithë dokumentacionin justifikues të shpenzimeve të realizuara gjatë fushatës elektorale me fatura të rregullta tatimore, kjo përbën bazë për të lëshuar raportin me rezervë.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit të Përgjegjësive të Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Partia Bindja Demokratike në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare, informacionet, përmbledhjet financiare si dhe deklaratat e subjektit në Republikën e Shqipërisë dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

SHOQËRIA AUDITUESE “ACA MARGJEKA” SH.P.K

(Audit, Consulting & Accounting Company)

Partner Angazhimi

Shkelzen MARGJEKA, Auditues Ligjor

Tiranë, me 12.12.2019

